

Afati për aplikim 05.01.2026 deri më 16.01.2026

TERMAT E REFERENCES

THIRRJE PËR OFRIMIN E OFERTAVE PËR FURNIZIM ME USHQIME TË SHPJETA/FAST FOOD DHE PIJE PËR AKTIVITETET E PROJEKTEVE TË IMPLEMENTUARA NGA OJQ "NEVO KONCEPTI"

Oferta duhet të përmbaj informatat e kërkuarit të ofertës si më poshtë:

Emri i OJQ-s	OJQ "NEVO KONCEPTI
NRF:	601188700
Adresa:	Rr.Adnan Krasniqi hyrja II kati 2 nr.8 Prizren

Objektiva: Përgaditja e ushqimeve të shpejta dhe sjellja në vendin e kërkuar.

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ "Nevo Koncepti" është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në formë të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ "Nevo Koncepti" bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes. Aktualisht OJQ "Nevo Koncepti" është duke zbatuar 4 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. KRITERET PËR PËRZGJEDHJE

Përzgjedhja e furnitorit do të përzgjidhet në bazë të qmimit ekonomikisht më të favorshëm.

Vlersimi bëhet sipas kriterëve më poshtë:

Nr.	Kriteret	Përqindja
1.	Ofrimi i çmimeve konkurruese në raport me furnizuesit e tjerë.	15%
2.	Dorëzimi në kohë i dokumenteve, duke përfshirë ofertën dhe faturën pas cdo blerje.	15%
3.	Numri i stafit ndihmës të operatorit ekonomik (OE).	20%
4.	Afërsia gjeografike e ofruesit të shërbimeve me	50%

3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Përgatitja e ushqimit sipas kërkesës,
- Sjella e ushqimit me kohë,
- Përgatitja e faturave me kohë,
- Pranimi i pagesës përmes Bankës.

4. AFATI KOHOR

Kërkesat për porosi do të bëhen gjithmonë së paku një ditë para, sipas planit të zhvillimit të aktiviteteve të parapara në bazë të projektit të implementuar nga OJQ “Nevo Koncepti”

5. REZULTATET E PRITSHME

- Bashkëpunim të mirë në mes të dy palëve.
- Ushqimi dhe pijet të jenë me qmime të njëjta dhe të liruara nga TVSH-ja gjatë periudhës së kontratës.
- Përgatitja e ushqimit me kohë dhe i freskët.
- Kujdesje në aspektin e afateve të produkteve dhe sanitarin.
- Faturimi i menjëhershëm pas blerjes.
- Komunikim i shpejtë dhe profesional për çdo problem ose vonesë të mundshme.
- Sigurimi i respektimit dhe zbatimit të plotë të kontratës, në përputhje me çdo nen kontraktual dhe çdo dakordim të arritur ndërmjet palëve kontraktuese.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen duke përfshirë këto dokumente:

- Oferta
- Kopja e regjistrimit të biznesit me numër unik identifikues

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 16.01.2026** deri në fund të orarit të punës **16:00**, në emailin prokurimi@nevokoncepti.org apo në formë fizike në selin e OJQ “Nevo Koncepti” Rr.Adnan Krasniqi nr.149, hyrja II, kati 2 nr.8 Prizren.